



autorë: Aldo Merkoçi / Xheni Lame

# QEVERISJA E HAPUR E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË SHQIPËRI

## PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES AKTUALE



**ActionSEE**



Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian, gjetjet dhe rekomandimet janë të autor-it/ve dhe nuk përbëjnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve

autorë: Aldo Merkoçi / Xheni Lame

# QEVERISJA E HAPUR E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË SHQIPËRI

## PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES AKTUALE

---

KY PROJEKT ËSHTË MBËSHTETUR FINANCIARISHT NGA BASHKIMI EUROPIAN.  
OPINIONET, GJETJET DHE REKOMANDIMET JANË TË AUTOR-IT/VE DHE NUK  
PËRBËJNË DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E DONATORËVE.

**TIRANË, MAJ 2017**

## HYRJE

Në bashkëpunim me partnerë nga rrjeti rajonal i OShC-ve "Action SEE", Lëvizja MJAF! ka përgatitur këtë punim mbi politikat, në të cilin janë analizuar nivelet e transparencës dhe llogaridhënies së pushtetit ekzekutiv në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Punimi paraqet rezultate të një kërkimi gjithëpërfshirës, bazuar në metodologji shkencore, kryer nga anëtarë të rrjetit të Action SEE përgjatë disa muajve të mëparshëm. Qëllimi i aktiviteteve tona është të përcaktojmë gjendjen aktuale në rajon përmes një matje objektive të qeverisjes së hapur të pushtetit ekzekutiv dhe për të adresuar rekomandime për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Gjithashtu, projekti ynë konsiston në përmirësimin e zbatueshmërisë së parimeve të qeverisjes së mirë, ku qeverisja e hapur zë një vend të rëndësishëm.

Politika e qeverisjes së hapur duhet të jetë një politikë e zbatuar në të gjitha qeveritë e rajonit dhe duhet të përkufizohet ashtu si politikat e tjera të rëndësishme, ashtu sikurse nuk duhet të vijë si rezultat i një vendimi aktual apo i gjendes së fuqisë aktuale. Çdo vend i rajonit ka kushtet e tij specifike të sferës politike, në të cilën ai zhvillon qeverisjes e tij të hapur, por një hapësirë e rëndësishme për një operacion të bashkuar rajonal në përmirësimin e gjendjes aktuale, mund të ishte një hap për t'u marrë në konsideratë.

Hyrja e konceptit të qeverisë së hapur në rajonin e Ballkanit Perëndimor ishte kërkuar nga proceset e integritetit apo motivuar nga përmirësimi i përshtypjeve ndërkombëtare të një shteti përmes pjesëmarrjes në nisma për një administratë transparente. Në përpjekje për të arritur trendet pozitive, një nevojë e brendshme thelbësore, e cila përfaqëson bazat për këtë parim, është shpesh e neglizhuar - është pikërisht qeveria e hapur ndaj qytetarëve dhe shoqërisë arsyjeja e krijimit të vlerës publike.

Kjo qasje na çon në një problem lidhur me zbatimin e rregullave të transparencës dhe përgjegjshmërisë qeverisëse, veçanërisht në nivele më të ulëta të administratës publike, ku rëndësia sociale e kësaj qasjeje nuk merret parasysh, por konsiderohet si një detyrim jo fort i pranuar i imponuar prej kërkesave ndërkombëtare. Prandaj, politika e qeverisë së hapur në vendet e rajonit kërkon jo vetëm të jetë e shkruar në dokumentat strategjike, por gjithashtu të advokojë me zë të lartë mbi konceptin e qeverisjes së hapur në funksionet më të larta shtetërore dhe sociale.

Propozimi jonë i adresohet vendim-marrësve të pushtetit ekzekutiv në vendet e rajonit në të gjitha nivelet: qeveria, ministritë dhe agjencitë ekzekutive. Ky punim mund të jetë e dobishëm për përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare dhe për kolegët e OShC-ve, të cilët punojnë mbi çështje të tilla.

Në mënyrë që të arrihet një dialog publik i cilësive të larta lidhur me

këto çështje, do të organizohet një sërë eventesh publike, në të cilat do të dëgjohen opinionet e të gjithë grupeve të të interesuarve dhe do të përpiqemi të gjejmë zgjidhje të përbashkëta të qëndrueshme për zhvillimin

e mëtejshëm të kësaj çështjeje.

Veç kësaj, gjithashtu do të zbatohen të gjitha parimet e transparencës së kërimit dhe do të informohen institucionet mbi të gjitha detajet e kryerjes së tij dhe konkluzionet e përshtatura.

Jemi në dispozicionin tuaj për të gjitha sugjerimet, kritikën dashamirëse dhe diskutimet lidhur me këtë punim!

## QEVERISJA E HAPUR E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NGA RAJONI

Pas analizës së një numri të dhënash, janë vënë re ngjashmëri dhe dallime lidhur me gjendjen në këtë fushë të vendeve të rajonit.

Përgjithësisht, rezultatet tregojnë se nga prespektiva rajonale, qeverisja e hapur e pushtetit ekzekutiv nuk është në nivele të kënaqshme. Ajo arrin pothuajse 47% të treguesve të saj të përmbushur. Politikat e qarta dhe konsistente të përgjegjshmërisë qeveritare, të përmendura në dokumentet strategjike, nuk ekzistojnë realisht. Një ndryshim i qasjes dhe trajtimit është i rëndësishëm në këtë segment të rëndësishëm të funksionimit aktual dhe të ardhëm të qeverisë.

Nuk ka një qasje strategjike mbi qeverisjen e hapur insitucionale në vendet e rajonit. Në bazë të të dhënave të mbledhura, mund të arrijmë në konkluzionin se ky koncept trajtohen në baza ad hoc dhënë shumë shteteve, politika e qeverisjes së hapur, e cila do të ishte e barabartë me trajtimin e politikave të tjera të ndërmarrja nga pushteti ekzekutiv, nuk është e krijuar. Politika e qeverisjes së hapur është e krijuar më së shumti për të prezantuar një vullnet të mirë të pushtetit ekzekutiv, por situata aktuale është larg nga ajo e dëshiruara. Për momentin, kjo është një përmbledhje e rregulloreve të ndryshme, akteve dhe detyrimeve, dhe jo një filozofi apo qasje e promovuar aktivisht nga qeveria. Transparenca, përgjegjshmëria dhe llogaridhënia në qeverisjen e mirë paraqesin parakushtet themelore të pushtetit ekzekutiv të cilësisë së lartë dhe nuk duhet të trajtohen si dëshirë opsionale për t'u ofruar ndaj qytetarëve.

Politika e përgjegjshmërisë nuk duhet të varet nga nismat e jashtme, por duhet të jetë pjesë e politikave të brendshme. Vetëm atëherë të gjitha nismat ndërkombëtare marrin pohim të plotë, duke qenë se ato përshtaten dhe përmirësohen mbi baza të shëndetshme në secilin shtet të rajonit.

Në një sistem me pjesëmarrje, është e nevojshme të adaptohen dokumenta strategjikë dhe plane aksioni vjetore, të cilat merren me zhvillimin e fenomenit të qeverisjes së hapur. Është e nevojshme, brenda shteteve, të planifikojnë zhvillimin dhe të për afrojnë përgjegjshmërinë e institucioneve të pushtetit ekzekutiv. Këto dallime janë të mëdha dhe çështja nëse këto institucione i përkasin të njëjtit vend, është e imponuar. Pas hyrjes së planeve strategjike, është e nevojshme të konsiderohet përshtatja e ligjit për Qeverinë dhe Ministrinë, duke qenë se kjo dhe çështje të tjera të lidhura me funksionimin e administratës publike, do të zgjidheshin në mënyrën më eficiente.

Monitorimi ynë ka treguar disa "pika kritike", si për shembull pengesa kritike për zhvillimin e qeverisjes së hapur institucionale në rajon.

## Transparenca dhe komunikimi

Qeveria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë zbatimit të ligjit mbi të drejtën e informimit, i cili, përgjithësisht, nuk ofron rezultate të kënaqshme. Vëmendja duhet të përqëndrohet edhe në kapacitetet dhe pavarësinë e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

Komunikimi me qytetarët është një tjetër segment i rëndësishëm, i cili duhet të përmirësohet në periudhat e ardhshme. Pavarësisht metodave të vjetra të komunikimit, pushteti ekzekutiv duhet të përdorë më shumë metoda moderne të komunikimit me qytetarët. Respektimi i parimit të publikimit të të dhënave në format open data<sup>1</sup> paraqet një problem rajon. Këto formate do të rrisin disponibilitetin dhe lehtësinë e aksesimit të të dhënave nga qytetarët.

## Planifikimi dhe shpenzimi i fondeve publike

Një vëmendje e veçantë duhet të drejtohet në forcimin e transparencës, duke qenë se qeveritë rajonale nuk plotësojnë praktikatat e publikimit të informacioneve financiare dhe dokumenteve.

Institucionet e pushtetit ekzekutiv, të cilat publikojnë informacione mbi buxhetin, duke e bërë këtë dokument të kuptueshëm për qytetarët dhe të shpjegojnë llojin e shërbimit që marrin për paratë që japin ndaj qeverisë, janë shumë të rralla. Veç kësaj, informacioni

në lidhje me sesa të planifikuara janë shpenzimet e fondeve është shumë i paktë. Është e nevojshme për të bërë transparente të gjitha pagesat nga buxheti i shtetit dhe për t'u lënë qytetarëve mundësinë të kontrollojnë shpenzimet në mënyrë personale.

Gjithashtu, në faqet zyrtare të pushtetit ekzekutiv nuk janë të publikuara planet për prokurimet publike, ndërkohë që thirrjet dhe vendimet lidhur me këto prokurime dhe kontratat e anekset përkatëse nuk janë të aksesueshme në shumicën e rasteve.

## Efienca, efektiviteti dhe pritjet e qytetarëve nga pushtetet

Një çështje e rëndësishme e funksionimit të pushtetit ekzekutiv dhe qeverisjes së hapur ndaj qytetarëve është krijimi i indikatorëve të qartë të suksesit të politikave të qeverisë, i cili do të jetë në dispozicion të qytetarëve. Pushtetet llogaridhënëse transformojnë premtimet e tyre zgjedhore në politika zyrtare shtetërore, por gjithashtu krijojnë mundësinë për qytetarët që të kontrollojnë rezultatet e tyre.

1) Open data janë të dhëna të strukturuar në formate të kuptueshme kompjuterike, të cilat janë mundësinë e përdorimit të vazhdueshëm.

Qeveritë rajonale ende duhet të vendosin metodat dhe procedurat unike për kontroll të cilësisë së lartë të politikave të tij, dhe ato nuk kanë zhvilluar metoda adekuate për matjen e performancës së politikave të tyre. Një vëmendje suficiente nuk është kushtuar për vendosjen e metodave unike sipas të cilave ministrinë do të mund të informonin qeverinë për punën e tyre në kuadër vjetor. Gjithçka e vënë re reflektohet negativisht në informimin e qytetarëve mbi performancën e politikë-bërjes.

## Qeverisja e hapur e pushtetit ekzekutiv në Shqipëri

Qeverisja e hapur e pushtetit ekzekutiv në Shqipëri kap shifrën 38% të përmbushjes së treguesve. Ky rezultat ishte i pritshëm

dhe është në përputhje me matjet e mëparshme të kryera në këtë fushë. Përmes negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian, Open Government Partnership dhe aktiviteteve të tjera, Qeveria vijoi me krijimin e politike për qeverisjen e hapur. Kjo gjë u zhvillua me iniciativa nga OJF-të dhe “Programi i Transparencës” një mënyrë

konkrete përmes së cilës, autoritetet tona publike ndërtuan dhe rritën transparencën në aktivitetet e tyre institucionale.

Promovimi i qeverisjes së hapur, barasverfshëm me politikat e tjera të pushtetit ekzekutiv, tentojnë të arrijnë rezultatet e tyre. Ky problem i promovimi të qeverisjes së hapur me siguri nuk do të ndodhë pasi janë institucionet që nuk respektojnë detyrimet e tyre në këtë fushë, parimet dhe praktikatat e qeverisjes së mirë pa pasoja. Kjo ka krijuar dallime të rëndësishme në qeverisjen e hapur të Qeverisë, Ministrive dhe Agjensive Ekzekutive. Në Shqipëri, të gjitha reformat e ndërmarra në administratën publike dhe rregullimet ligjore na kanë dhënë një pamje më të mirë qeverisëse, por performanca aktuale e ekzekutivit tregon ndryshueshmëri.

Një argument shtesë për adaptimin e dokumentit strategjik që rregullon këtë veprimtari është fakti se qeverisja e hapur dukshëm zvogëlohet kur lëvizim drejt institucioneve të cilat janë në një nivel të ulët hierarkie. Është e qartë se ka një numër të dukshëm institucionesh, të cilat pengojnë zbatimin e parimeve të qeverisjes së hapur, ato duhet të punojnë sistematikisht mbi këtë problem me përfshirjen e manaxherëve të kualifikuar në sistem.

Të gjitha këto dëshmojnë për një sinjal të qartë që kërkon një ndërhyrje të shpejtë dhe punë të përkushtuar në mënyrë që të përmirësohen praktikatat ose rregulloret për këtë qëllim. Strategjia e zhvillimit dhe promovimit të qeverisjes së hapur nuk duhet të jetë vetëm e shkruar, por duhet një zbatim efektiv për të përmirësuar transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje.

## QEVERIA E SHQIPËRISË

Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka arritur në vlerat 58% të përmbushjes së indikatorëve mbi qeverisjen e hapur. Në prespektivën e rajonit, ky vlerësim le të kuptohet se ka ende vend për përmirësime sa i takon Ekzekutivit Shqiptar, edhe pse vlerësimi është shumë i përafërt me përqindjen e transparencës së vendeve të tjera. Megjithatë, Shqipëria, ashtu sikurse edhe vendet e tjera të Ballkanit, synon të arrijë standardet ndërkombëtare në aspektin e qeverisjes transparente dhe ky vlerësim tregon për punën që mbetet ende përpara për t'u bërë.

Transparenca e plotë e sesioneve të qeverisë përbën problem në vendin tonë. Në faqen zyrtare të Kryeministrisë nuk gjenden axhendat për veprimtarinë e sesioneve të parashikuara për t'u zhvilluar. Mbledhjet zhvillohen me dyer të mbyllura, duke mos lejuar pjesëmarrjen e mediave në diskutimet ndërmjet të pranishmëve. Gjithashtu, pas përfundimit të sesioneve, nuk është e mundur të aksesohen dokumentat që lidhen me diskutimet dhe procesverbalet e veprimtarisë së sesioneve, për t'u krijuar qytetarëve dinamikën e diskutimeve mbi politikat specifike që prekin drejtpërdrejt interesat dhe cilësinë e tyre të jetesës.

Në lidhje me përbërjen strukturore të burimeve njerëzore të qeverisë shqiptare, mungon informacioni mbi emrat e nëpunësve publik, pozicionet e punës, përshkrimet e punës, si dhe të pasurive që disponojnë zyrtarët e lartë.

Një tjetër problematikë lidhet me publikimin e “Ligjit për Buxhetin” për vitin aktual të monitorimit dhe dy vitet e mëparshme. Vihet re mungesë e tabelave me zërat e buxhetit, të aksesueshme dhe të kuptueshme nga qytetarët, mungesë e raporteve të ndërmjetme të shpenzimeve vjetore dhe

të gjitha shpenzimeve totale të kryera përgjatë vitit, si dhe mospublikim i buxhetit të dedikuar për qytetarët. Gjithashtu, mungojnë raporte mbi gjenden aktuale të borxhit publik të vendit tonë dhe mënyrës sesi ky borxh menaxhohet nga qeveria.

I gjithë dokumentacioni që lidhet me prokurimet publike, i rregulluar sipas ligjit për Prokurimet Publike, mungon në faqen zyrtare të kryeministrisë. Këtu përfshihen planet për prokurimet vjetore, thirrjet për realizimin e prokurimeve, rezultati i procedurës dhe vlerësimi i saj.

Raportet vjetore të publikuara të punës, të cilat i japin mundësinë qytetarëve dhe gjithë grupeve të interesit të njohin dhe të kontrollojnë veprimtarinë e qeverisë, i takojnë vitit 2014 dhe 2015, të publikuara në formate të paeditueshme dhe të ripërdorshme nga qytetarët. Ndërkohë që programi i punës i takon vetëm vitit të parë të qeverisë, duke mos bërë me dije ndaj qytetarëve edhe programet për vitet pasardhëse, gjë e cila e bën të vështirë krahasimin se çfarë është realizuar nga çfarë qeveria ka parashikuar.



Është e rëndësishme të përshtaten udhëzues brenda strukturave shtetërore se në ç'mënyrë duhet të publikohen të dhënat në faqet zyrtare në formatin e të dhënave të aksesueshme dhe të përdorshme. Vlerësimi i Qeverisë Shqiptare për të dhënat e editueshme të ofruara publikisht është 6.66%, duke e renditur kështu vendin tonë të fundit krahasimisht me vendet e rajonit.

Në çështjet e integritetit, Qeveria Shqiptare mbetet gjithashtu në vlera të ulëta në rajon, ku pavarësisht se institucioni përgjigjet se ka një mekanizëm të qartë për zbatimin e Kodit të Punës në rregullimin e brendshëm të veprimtarisë, ky dokument nuk është i publikuar në faqen zyrtare të Kryeministrit. Ndërsa lobingjet ende nuk janë të rregulluara nga ana ligjore në vendin tonë.

## Ministritë

Ministritë e Shqipërisë plotësojnë kriteret e qeverisjes së hapur mesatarisht në 35% të treguesve. Ky nuk është një rezultat pozitiv për Ministritë Shqiptare, ndaj është e nevojshme që ato të punojnë fort në këtë drejtim.

Ndryshimet në rezultate ndërmjet Ministrive në Shqipëri janë të dukshme, renditja më e mirë e një Ministrie i takon asaj të Zhvillimit Ekonomik,

Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarjes, në kuotën e 57% të plotësimit të kriterëve dhe ajo që përfaqëson nivelin më të dobët për plotësimin e kushteve është Ministria e Shtetit për Marrëdhënie me Parlamentin në kuotën e 2.59%, një ministri e re, e cila është në pozita varësie nga Kryeministria dhe nuk ka buxhet dhe website.

Ministritë nuk janë mjaftueshëm të përkushtuara për të informuar publikun mbi punën e tyre. Në këtë mënyrë, duke kërkuar nëpër websitet e tyre, të interesuarit nuk mundën të gjejnë se çfarë ministritë planifikojnë të bëjnë dhe çfarë rezultatesh kanë arritur ato gjatë vitit. Faqet zyrtare të ministrive përmbajnë informacion që në shumicën e rasteve nuk është i sistemuar. Rubrikat specifike të cilat janë të zbrazura ose janë të papërditësuara, me mundësi shumë të kufizuara për kërkime. Si pasojë, websitet përngjajnë me përmbajtje enigmatike të informacionit. Parimet e publikimit të të dhënave në formatin open data nuk janë respektuar dhe nuk ka një parim unifikues rreth përditësimit të vazhdueshëm e llogarive në rrjetet sociale.

Ministritë në Shqipëri kanë publikuar në websitet e tyre zyrtare 52.8% të informacioneve organizative. Në websitet e Ministrive është e vështirë të gjendet informacion i detajuar rreth emrave, të ardhurave dhe kontaktet e zyrtarëve publik. Websitet zyrtare përmbajnë vetëm informacion të përgjithshëm mbi informacionin organizativ. Ministritë gjithashtu shkëlqin Ligjin për të Drejtën e Informimit duke publikuar vetëm 8.7% të

informacionit të poseduar rreth emrave, të ardhurave dhe kontakteve për zyrtarët publik. Vetëm 2.63% e informacionit mbi nënpunësit civilë dhe punonjësit shtetërorë me tituj janë të publikuara.

Vetëm 17% e ministrive publikojnë buxhetet e tyre për periudhën e hershme 3 vjeçare në websitet e tyre zyrtare, ndërsa për 68.7% e ministrive nuk ka informacion për buxhetet e më hershme për periudhën tre vjeçare në websitet e tyre. Gjithashtu, 86% e ministrive nuk kanë asnjë llogari përmbledhëse nga periudha e hershme tre vjeçare në websitet e tyre zyrtare.

Përveç këtyre, 84% e Ministrive nuk publikojnë planet e prokurimeve publike për vitet e shkuara. Monitorimi tregoi se vetëm 2.6% e ministrive publikojnë thirrjet dhe vendimet mbi prokurimet publike, por ato nuk publikojnë kontratat dhe anekset në lidhje me prokurimet publike.

26% e Ministrive kryejnë konsultime publike dhe 42% e Ministrive publikojnë konsultimet në format të dhënash.

Duke marrë në konsideratë të dhënat e përmendura dhe të dhënat të cilat ne nuk kemi përmendur për shkak të kufizimeve të ndryshme, është e qartë se përqasja ndaj qeverisjes së hapur duhet të ndryshojë krejtësisht në përputhje me parimet e përmendura në prezantimin hyrës të këtij dokumenti.

### Agjensitë Ekzekutive

Agjensitë Ekzekutive përmbushin vetëm 21.31% të treguesve të përgjegjshmërisë.

43.15% e këtyre institucioneve kanë website zyrtar, por shpesh herë ato janë të papërditësuara dhe në 61.5% të rasteve është shumë e vështirë të gjenden dokumentat e kërkuara. Veçse 26.92% e Agjensive Ekzekutive kanë një llogari aktive në rrjetet sociale.

Këto institucione të administratës publike, shkelin Ligjin për të Drejtën e Informimit në pjesën që ka të bëjë me publikimin aktiv të informacionit, ku vetëm 17.77% e tyre publikojnë raportet vjetore të punës në websitet e tyre, 19.23% e tyre publikojnë listën e nënpunësve civil dhe punonjësve shtetëror me tituj, por vetëm 5.08% e institucioneve publikon informacion se kush janë zyrtarët e tyre publik, vlerën e tyre të të ardhurave dhe kontaktet e tyre, 69.23% e institucioneve publikojnë në website, ligjet dhe rregulloret që kontrollojnë punën e institucioneve të tyre.

Vetëm 2.54% e këtyre institucioneve publikojnë buxhetin e tyre në website. Transparenca buxetore e Agjensive është 2.33%, duke pasur parasysh se të dhënat mbi llogaritë përmbledhëse dhe raportet e ndërmjetme mujore për shpenzimin e buxhetit nuk janë të aksesueshme për qytetarët.

Përsa i përket prokurimeve publike, 7.7% e këtyre institucioneve publikojnë planet e prokurimeve publike në website, por ajo që vihet re është mungesa e informacionit në lidhje me thirrjet dhe vendimet e prokurimeve publike. Vetëm 11.54% e institucioneve publikojnë kontratat dhe anekset e marrveshjeve të prokurimeve publike.

## METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Qeverisja e hapur përfaqëson një kusht kyç të demokracisë pasi kjo u lejon qytetarëve të marrin informacion dhe njohuri të nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendim-marrje efektive dhe pasjen e institucioneve të përgjegjshme për politikatat të cilat ato ndjekin.

Rreth botës, institucionet ndërmarrin aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e transparencës së tyre dhe llogaridhënien te qytetarët. Indeksi Rajonal për Qeverisjes e Hapur të pushtetit ekzekutiv është ndërtuar në qëllim të përcaktimit se në cilën shkallë qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin dhe kuptojnë informacionin e institucioneve të tyre.

Indeksi Rajonal i Qeverisjes së hapur mat shkallën në të cilën institucionet e Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë, dhe ai bazohet në katër parimet bazë si vijon: 1) Transparenca 2) Aksesueshmëria 3) Integriteti dhe 4) Efektshmëria

**Parimi i transparencës** përfshin informacionin organizativ, buxhetin dhe procedurat e prokurimeve publike të cilat janë në dispozicion të publikut dhe të publikuara. **Aksesueshmëria** është e lidhur me sigurimin dhe respektimin e procedurave për akses të lirë në informacion, duke përmirësuar disponueshmërinë e informacionit përmes mekanizmave të debatit publik dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. **Integriteti** përbëhet nga mekanizmi i parandalimit të korrupsionit, mbajtjen e kodit etik dhe rregulloret e lobimit. Parimi i fundit, **Efektshmëria** i referohet monitorimit dhe vlerësimit të politikave të zbatuara nga institucionet.

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet sikurse dhe shembuj të praktikave të mira, këto parime janë zhvilluar më tej përmes treguesve specifik cilësorë dhe sasiorë, të cilët janë vlerësuar në bazat e: aksesueshmërisë së informacionit në websitet zyrtare të institucioneve, shqyrtimin e kuadrit ligjor për çështje të veçanta, burimeve të tjera të informacionit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione.

Përmes rreth 80 treguesve për çdo institucion ne kemi matur dhe analizuar përgjegjshmërinë e 275 institucioneve të pushtetit ekzekutiv dhe janë mbledhur 15000 të dhëna në lidhje me institucionet.

**MATJET JANË KRYER NË PERIUDHËN NGA TETORI  
DERI NË FUND TË DHJETORIT 2016. JANË ZHVILLUAR  
DHE DËRGUAR TEK INSTITUCIONET, NJË SET ME  
REKOMANDIME DHE UDHËZIME TË BAZUARA NË GJETJET  
KRYESORE TË KËRKIMIT.**